VENDIM
Nr.144, datë 23.2.2011

PËR NJË NDRYSHIM NË VENDIMIN NR.1269, DATË 17.9.2008 TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE "PËR PËRBËRJEN, MËNYRËN E FUNKSIONIMIT DHE DETYRAT E PËRGJEGJËSITË E STRUKTURAVE SHTETËRORE, TË NGARKUARA PËR SHQYRTIMIN E VLEFSHMËRISË LIGJORE TË KRIJIMIT TË TITUJVE TË PRONËSISË MBI TOKËN BUJQËSORE", TË NDRYSHUAR

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të nenit 11 të ligjit nr.9948, datë 7.7.2008 "Për shqyrtimin e vlefshmërisë ligjore të krijimit të titujve të pronësisë mbi tokën bujqësore", të ndryshuar, me propozimin e Ministrit për Inovacionin dhe Teknologjinë e Informacionit e të Komunikimit, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Paragrafi i fundit i pikës 2 të shkronjës "A" të kreut III "Përbërja, mënyra e funksionimit, detyrat dhe përgjegjësitë e komisionit vendor të vlerësimit të titujve të pronësisë (KV)", të vendimit nr.1269, datë 17.9.2008 të Këshillit të Ministrave, të ndryshuar, ndryshohet si më poshtë vijon:

"Komisionet vendore prej 3 (tre) anëtarësh duhet të kenë, të paktën, 1 (një) jurist.
Komisionet vendore prej 5 (pesë) anëtarësh duhet të kenë, të paktën, 3 (tre) juristë.
Komisionet vendore prej 6 (gjashtë) anëtarësh duhet të kenë, të paktën, 4 (katër) juristë.
Komisionet vendore prej 7 (shtatë) anëtarësh duhet të kenë, të paktën, 5 (pesë) juristë.".

2. Ngarkohen prefektët e qarqeve për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha